



Nga: Koalicioni i Organizatave për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF dhe Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Për: z. Bahri Hyseni, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Lënda: Kërkesë për hetim dhe llogaridhënie për veprimet e prokurorisë

Data: 19 korrik 2019

I nderuari z. Hyseni,

Po ju shkruajmë lidhur me rastin tragjik të vrasjes së fëmijës K. V nga Fushë Kosova.

Koalicioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve – KOMF dhe Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, ÇOHU! kërkojnë hetim dhe llogaridhënie për veprimet e prokurorisë lidhur me rastin e fëmijës K. V nga Fushë Kosova.

Bazuar në deklaratat zyrtare të organeve të ndjekjes dhe raportimet mediale, fëmija K. V është raportuar në Polici për keqtrajtim seksual nga tashmë i dyshuari kryesor S.O.

Për herë të parë ky rast është paraqitur në Polici me 29 janar 2019 dhe bazuar në Kallëzimin Penal të datës 12 prill 2019, rasti është proceduar në prokurori me 12 prill 2019.

Pas publikimit të vdekjes tragjike të fëmijës në Komunën e Fushë Kosovës, KOMF ka dërguar kërkesë zyrtare tek Prokuroria për të parë cili ka qenë reagimi institucional për këtë rast. Prokuroria ka theksuar se është në fazën e hetimeve dhe për shkak të ndjeshmërisë së rastit nuk mund të japë më shumë informacion.

Sipas raportimeve mediale, prokurori nuk kishte propozuar masën e paraburgimit, e cila përveçse do të pamundësonte ushtrimin e vazhdueshëm të abuzimit ndaj fëmijës do të ndihmonte edhe në zbardhjen e rastit. Prokurori nuk kishte kërkuar ekzaminimin mjeko-ligjor, kjo edhe përkundër raportimeve dhe dyshimeve për abuzim seksual me tashmë të ndjerin K.V. Tutje i dyshuari ishte liruar në procedurë të rregullt.

Nisur nga faktet e mësipërme, kërkojmë të vërtetohet nëse prokuroria ka përmbushur përgjegjësinë profesionale bazuar në dispozitat ligjore dhe etike, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Sjelljes Etike dhe Profesionale për Prokurorë.

Në përputhje me rregullat ligjore dhe etike të organeve ndjekëse, kërkojmë që Këshilli Prokurorial të zhvillojë procedurë hetimi ndaj prokurorëve të rastit për të identifikuar nëse ka pasur lëshime profesionale dhe etike në rastin ndaj fëmijës K. V dhe të shqiptojë masat e nevojshme, në rast se ato vërtetohen.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin profesional, mbetemi në pritje të veprimeve konkrete të KPK-së lidhur me rastin.

Sinqerisht,

KOMF
Organizata ÇOHU!